

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 145/10,136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe në bazë të njoftimit të përqendrimit i parashtruar nga Shoqëria për Shërbime biznesi dhe tregti CITI PLAZA SHPK Shkup me seli në rrugën Shën Kirili dhe Metodi nr. 7 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, i dorëzuar përmes Shoqërisë së Avokateve Debarliev, Dameski dhe Qeleshoska nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 24 mars 2021, mori këtë:

### **AKTVENDIM**

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Shoqëria për Shërbime biznesi dhe tregti CITI PLAZA SHPK Shkup me seli në rrugën Shën Kirili dhe Metodi nr. 7 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut do të fitoj kontroll mbi Ramstore Bullgaria EAD, me seli të regjistruar në rr. Lajosh Koshut nr. 33, kati i 5-të, banesa 26, Sofje, Bullgari, duke përvetësuar 100% të aksioneve në Ramstore Bullgaria EAD, i cili indirekt Siti Plaza SHPK Shkup do të fitoj një pjesë që përfaqëson 99% të kapitalit themelor në Shoqërinë për tregti dhe shërbime RAMSTORE MAQEDONIA SHPK Shkup, me seli të regjistruar në rr. Shën. Kirili dhe Metodi nr. 13, Shkup – Qendra, Republika e Maqedonisë së Veriut, megjithëse bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në pajtim me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet të paguaj taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6 000,00 den. si dhe për Vendimin në shumën prej 30.000,00 den, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 и 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogaria e pagesës 840.....03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

### **Arsyetim**

Në pajtim me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, me datë 12.03.2021, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni) është dorëzuar një njoftim për përqendrim nga Shoqëria për Shërbime biznesi dhe tregti CITI PLAZA SHPK Shkup me seli në rrugën Shën Kirili dhe Metodi nr. 7 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut do të fitoj kontroll mbi Ramstore Bullgaria EAD, me seli të regjistruar në rr. Lajosh Koshut nr. 33, kati i 5-të, banesa 26, Sofje, Bullgari, duke përvetësuar 100% të aksioneve në Ramstore Bullgaria EAD, i cili indirekt Siti Plaza SHPK Shkup do të fitoj një pjesë që përfaqëson 99% të kapitalit themelor në Shoqërinë për tregti dhe shërbime RAMSTORE MAQEDONIA SHPK Shkup, me seli të regjistruar në rr. Shën. Kirili dhe Metodi nr. 13, Shkup – Qendra, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazë të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij, konstatoi si në vijim:

### **Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:**

**Siti Plaza SHPK** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në përputhje me ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Një ortak që zotëron 97,18% të kapitalit aksionar të Siti Plaza SHPK është një shoqëri për prodhimin dhe tregtinë e EUROASIA TEHNIKA Ajdovan etj..Eksport-Import SHPK Shkup, me seli në rr. Kej Dimitar Vllahov nr. 1 Shkup - Qendër, ndërsa pjesa e mbetur në shumën prej 2.82% të kapitalit aksionar është pjesa e vet e Siti Plaza SHPK .Pronari përfundimtar i Siti Plaza SHPK është z. Ajdovan Ademoski.

Siti Plaza SHPK është e pranishme në tregun relevant për dhënien me qira të hapësirës për shitje me pakicë në qendrat tregtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes pronësisë së qendrës tregtare Kapitol Moll Shkup (Capitol Mall Skopje). Siti Plaza SHPK nuk është e pranishme në tregun relevant në tregjet me pakicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Z. Ajdovan Ademoski ushtron kontroll mbi Siti Plaza SHPK përmes pjesëmarrjes së tij në kapitalin e dy shoqërive të varura - EUROASIA TEKNIKAL AJDOVAN dhe të tjerët. Eksport-Import SHPK Shkup dhe PERA KOMSTRAKSHN INTERNACIONAL SHPK Shkup me seli në rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 7 Shkup - Qendër, por ato nuk janë të pranishme në tregjet relevante në Maqedoninë e Veriut, d.m.th. janë të pranishme në tregun e hotelerisë respektivisht ndërtimtarisë. Siti Plaza SHPK është një partner në Shoqërinë për shërbime turistike dhe akomodim STONEBRIDGE-HOTEL SHPK Shkup, me seli në Kej. Dimitar Vllahov Nr. 1 Shkup - Qendër me një pjesë prej 87.19% të kapitalit themelor.

**Ramstore Bullgaria EAD** është shoqëri aksionare private e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Bullgarisë. Ramstore Bullgaria EAD që nga viti 2007 ka ndaluar kryerjen e të gjitha llojeve të aktiviteteve në Republikën e Bullgarisë dhe është tërhequr nga tregu i shitjes me pakicë në Republikën e Bullgarisë.

Ramstore Bullgaria EAD ka të regjistruar një korporatë dhe është e regjistruar në Maqedoninë e Veriut përmes Ramstore Maqedonia SHPK përmes pjesës së saj në Ramstore Maqedonia SHPK që është 99% nga kapitali themelor i shoqërisë. Të ardhurat totale të Ramstore Bullgaria EAD rrjedhin ekskluzivisht nga pronësia e kapitalit në Ramstore Maqedoni SHPK. Përveç pjesës në Ramstore Makedonija SHPK, Ramstore Bullgaria EAD nuk posedon pjesë në shoqëri të tjera.

Ramstore Makedonija SHPK është shoqëri tregtare e regjistruar në përputhje me ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e pranishme në tregu për marrjen me qira të hapësirës për shitje me pakicë në qendra tregtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes qendrës tregtare Ramstore Mol Shkup (Ramstore Mall Shkup), e cila është në pronësi të Ramstore Maqedonia SHPK dhe në tregun me pakicë përmes rrjetit të supermarketeve Ramstore, të pranishëm në tregun e Maqedonisë së Veriut me 28 tregje me pakicë të vendosura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të përcaktojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

### **Udhëzim për mjetin juridik**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritje të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

**KRYETAR**  
**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**  
**Prof. Dr. Vladimir Naumovski**